

**STATUTI I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“X Energy” SH.P.K**

**KAPITULLI I  
THEMELIMI, OBJEKTI, SELIA, DHE HAPËSIRA NË INTERNET**

**Neni 1: Themelimi**

Sot, me 21/09/2023 (dymije e njezet e tre), ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptar respektivisht ligjit Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, themeluesit, kane krijuar nje shoqi me pergjegjesi te kufizuar me emrin **“X Energy” shpk**

Ortaket e shoqerise janë:

- **Shoqeria e te drejtes shqiptare D Energy Albania shpk**, regjistruar me NUIS M11724036S, e perfaqesuar ne kete statut nga Administratorja, znj. Ana Arapi, shtetase shqiptare, lindur me 04.09.1988, ne Tirane, dhe banuese ne Tirane, mbajtese e leternjoftimit me nr. Personal I85904052J;
- **Shoqeria e te drejtes shqiptare Enerwind shpk**, regjistruar me NUIS M11807011U, e perfaqesuar ne kete statut nga Administratorja, znj. Jola Haxhistasa, shtetase shqiptare, lindur me 08.06.1980, ne Berat, dhe banuese ne Tirane, mbajtese e leternjoftimit me nr. Personal I0560806;
- **Shoqeria e te drejtes shqiptare Faico Solar shpk**, regjistruar me NUIS M11724038L, e perfaqesuar ne kete statut nga Administratorja, znj. Jola Haxhistasa, shtetase shqiptare, lindur me 08.06.1980, ne Berat, dhe banuese ne Tirane, mbajtese e leternjoftimit me nr. Personal I05608063E
- **Shoqeria e te drejtes shqiptare Finova Albania LLC shpk**, regjistruar me NUIS M11725003B, e perfaqesuar ne kete statut nga Administratorja, znj. Romina Hasanaj, shtetase shqiptare, lindur me 15.04.1994, ne Tirane, dhe banuese ne Tirane, mbajtese e leternjoftimit me nr. Personal J45415042Q
- **Shoqeria e te drejtes shqiptare Valorem Energy shpk**, regjistruar me NUIS M11727012K, e perfaqesuar ne kete statut nga Administratorja, znj. Romina Hasanaj, shtetase shqiptare, lindur me 15.04.1994, ne Tirane, dhe banuese ne Tirane, mbajtese e leternjoftimit me nr. Personal J45415042Q

**Neni 2: Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria ka si objekt veprimtarie:

- Prodhimin e energjise elektrike nga burime te rinovueshme;
- Ndertimi i centraleve prodhue se per prodhimin e energjise se rinovueshme
- Import-eksport, tregtim, furnizim me shumice dhe pakice te energjise elektrike.
- Cdo aktivitet tjeter qe perputhet me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe qe konsidrohet nga shoqeria me perfitim dhe i dobishem per arritjen e objektivave te saj kryesore;

**Neni 3: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike e Shoqërisë Tregtare **“X Energy” sh.p.k** fillon me regjistrimin juridik dhe fiskal te saj dhe do te vazhdoje për një periudhe te pacaktuar.

Ajo mund te shpërbehet ne çdo moment, sipas vendimeve te marra nga asambleja e ortakeve.

**Neni 4: Selia, hapësira në internet dhe adresa elektronike**

- (1) Shoqëria e ka selinë ligjore te regjistruar në adresën: Njesia Bashkiake Nr. 1, Rruga Hasan Sufa, Pallati 3, Shkalla 1, Tirane.
- (2) Shoqëria mund të zhvillojë veprimtarinë e saj ekonomike në të gjithë territorin e Shqipërisë si edhe jashtë saj duke hapur degë dhe/ose zyra përfaqësimi, filiale, agjenci etj. në qendra të tjera administrative në përputhje me legjislacionin e vendeve në të cilat ato hapen.

**KAPITULLI II**  
**Kapitali dhe kuotat**

**Neni 5: Shumat dhe pagesat e kapitalit themeltar**

Kapitali i shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë. Kapitali i shoqërisë perbehet nga 5 (pese) kuota ne zotërim te ortakeve si ne vijim:

- Shoqeria D Energy Albania shpk, mbajtëse e 1 (nje) kuote, te barabrate me 20% te pjesëmarrjes ne kapitalin e shoqërisë, te barazvlefshme me 20 leke (njezet);
- Shoqeria EnerWind shpk, mbajtëse e 1 (nje) kuote, te barabrate me 20% te pjesëmarrjes ne kapitalin e shoqërisë, te barazvlefshme me 20 leke (njezet);
- Shoqeria Faico Solar shpk, mbajtëse e 1 (nje) kuote, te barabrate me 20% te pjesëmarrjes ne kapitalin e shoqërisë, te barazvlefshme me 20 leke (njezet);
- Shoqeria Finova Albania LLC shpk, mbajtëse e 1 (nje) kuote, te barabrate me 20% te pjesëmarrjes ne kapitalin e shoqërisë, te barazvlefshme me 20 leke (njezet);
- Shoqeria Valorem Energy shpk, mbajtëse e 1 (nje) kuote, te barabrate me 20% te pjesëmarrjes ne kapitalin e shoqërisë, te barazvlefshme me 20 leke (njezet);

**Neni 6: Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.


Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7: Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;



- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

#### Neni 8: Kalimi i pjesëmarrjes me kontratë

1. Kontrata e kalimit të pjesëmarrjes bëhet me shkrim dhe në bazë të formalitetave të vendosura nga Administratorët. Kalimi i pjesëmarrjes i njoftohet shoqërisë ne selinë e saj ligjore.

2. Ne rastin e transferimit me ane te shitjes, rezervohet ne favor te ortakeve te tjere e drejta e parablerjes.

Per kete qellim ortaku qe ka ndërmend te shesë tërësisht ose pjesërisht pjesëmarrjen e tij duhet te njoftoje me ane te letres rekomande ortaket e tjere, duke saktësuar çmimin dhe modalitete te tjera te shitjes.

Ortaket e tjerë mund te behën blerës te pjesëmarrjes se ofruara ne proporcione pjesëmarrjen e shoqerise te zotëruara nga ata.

Brenda tridhjete ditëve nga komunikimi i bere nga ortaku qe ka ndërmend te shesë pjesëmarrjen e tij, ortaket e tjere duhet te komunikojne nese kane ndermend te ushtrojnë te drejtë e parablerjes. Pasi ka skaduar ky afat dhe asnjë ortak nuk ka kerkuar blerjen e pjesëmarrjes, e drejta e parablerjes do te quhet e ezauruar.

Ne rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, transferimi tek te tretet jo ortake eshte sidooqofte i varur nga miratimi i ortakeve te tjere;

3. Momenti i kalimit te pronesise percaktohet ne kontraten e shitjes se pjesëmarrjes dhe ka efekt ndaj te treteve me regjistrimin e ndryshimeve perkatese ne Regjistrin tregtar.

### KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE


#### Neni 9: Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te përcaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;



- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- l) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- m) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- n) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- o) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të vaprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 10: Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me çdo mjet tjetër te përshtatshëm per kete qellim, per shembull nëpërmjet postës elektronike drejtuar ortakut. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 11: Kuorumi**

Mbledhjet mund te mbahen ne Shqiperi ose jashtë saj, me praninë, personalisht, me ane te autorizimit me shkrim ose me video-konference, te kuorumit te kërkuar ne vijim te këtij statuti.

Ne rastin kur mbledhja mbahet ne video-konference, Kryetari i mbledhjes dhe sekretari i saj duhet te jene ne te njëtin vend ne menyre qe te përpilojnë dhe nënshkruanë procesverbalin e mbledhjes. Ne kete rast eshte e nevojshme qe mbledhja te mbahet me praninë e nje noteri.


Në rastin e e mbledhjeve qe kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30% te pjesemarrjes.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 51% te pjesemarrjes.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

#### **Neni 12: Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.



Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështjet e tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve
  - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqerise.

#### **Neni 13: Përjashtimi nga e drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

#### **Neni 14: Administrimi**

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

#### **Neni 15: Kompetencat e Administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen përmbytjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmes Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmiratim së shoqërisë tregtare;

h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret Jane te detyruar te thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqerinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqerinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Neni 16: Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuar nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastojt përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarise së shoqërisë në mjesht;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.



4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesëpadisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### Kreu IV Viti finanziar-ekspertet

##### **Neni 17: Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 18: Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithe vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.


Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

#### Kreu V Prishja –riorganizimi i shoqërisë

##### **Neni 19: Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës;



Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prejtjë emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoperi ne likuidim e siper".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 20: Riorganizmi i shoqërises bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare."

**Neni 21: Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te pote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 22: Mosmarrëveshjet**


Për mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërises dhe te tretëve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

**ORTAKE TE SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"X Energy" shpk**

Shoqeria D Energy Albania shpk  
Perfaqesuar nga administratorja  
Znj. Ana Arapi




Shoqeria Faico Solar shpk  
Perfaqesuar nga administratorja  
Znj. Jola Haxhistasa



Shoqeria Valorem Energy shpk  
Perfaqesuar nga administratorja  
Znj. Romina Hasanaj



Shoqeria EnerWind shpk  
Perfaqesuar nga administratorja  
Znj. Jola Haxhistasa



Shoqeria Finova Albania LLC shpk  
Perfaqesuar nga administratorja  
Znj. Romina Hasanaj

